

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**NOEL - CO SHPK**

**Neni 1: Emri dhe forma ligjore**

Sot më datë 23.09.2021, une i nenshkruari:

**Esmeralda HODAJ**, e datëlindjes 15-06-1977, banuese në Durrës,  
madhore e me zotesi të plotë juridike e për të vepruar, mbajtës i kartes  
identitetit me nr. nr. Personal H75615187F

themelojme një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin :

**NOEL - CO SHPK**

Shoqëria rregullon veprimtarinë e saj në përputhje me Aktin e  
Themelimit, Statutin e saj, me ligjin 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe  
shoqëritë tregtare”

**Neni 2: Selia**

**Lagjja 14, Rruga Martin Camaj, Shkozë, Zona Kadastrale 8515,  
Godinë me Nr. Pasurie 4/472, Kati I-re, Durrës**

Shoqëria mund të hapë edhe seli të tjera operative, filiale, përfaqësi dhe  
agjensi në të gjithë territorin e Shqipërisë si dhe jashtë saj, në përputhje me  
legjislacionin shqiptar dhe ligjet e vendeve ku ato hapen.

### **Neni 3: Objekti**

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë si më poshtë:

- Import - eksport, tregtimin, prodhimin, perpunimin, transformimin, ambalazhimin e artikujve tekstile, veshmbathje, konfeksione të ndryshme, aksesoreve, fijeve, pelhurave, lendeve të para për industrinë e konfeksioneve, etj, të gjitha llojeve e formave, etj .
- Aktivitet në fushën e regjimit të perpunimit aktiv Fason.
- Tregtim artikuj të ndryshëm të çdo tipi, industriale, makineri e pajisje të ndryshme .
- Transport kombëtar dhe ndërkombëtar mallrash për vetë dhe për të treta.
- Shoqëria sipas nevojave të aktivitetit ka të drejtën e ushtrimit të çdo aktiviteti të ligjshëm, të lejueshëm për formën e shoqërisë, e cila nuk ndalohet me ligj(sipas nenit 7 të Ligjit nr.9901,dt.14.04-08).

### **Neni 4: Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat.

### **Neni 5: Kapitali**

Kapitali i shoqërisë është 10.000 lekë, i ndarë në 1 kuotea.

Kontributi i ortakëve në kapitalin e shoqërisë është vlerësuar sipas të dhënave të mëposhtme:

**Esmeralda HODAJ** është zotërues i 1 kuote, me 100% pjesëmarrje në kapitalin e shoqërisë me vlerë 10.000 leke.

### **Neni 6: Organet drejtuese të shoqërisë**

Organet drejtuese të shoqërisë do të jenë:

(-) Asambleja e Përgjithshme.

(-) Administrator i shoqërisë do të jetë **Znj. Esmeralda HODAJ**, e datelindjes 09.06.1996, me nr. Identifikimi J65609036T, për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë riemërimi.

### **Neni 7: Viti ushtrimor**

Viti ushtrimor fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor.

### **Neni 8: Dispozitat e fundit**

Shoqëria respekton ligjin dhe statutin që është pjesë e pandarë e këtij akti.

Për çdo gjë tjetër, që nuk është shkruar shprehimisht në këtë statut, zbatohet legjislacioni në fuqi për shoqëritë tregtare, për QKR-në si dhe çdo ligj tjetër mbi veprimtarinë e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar.

Emri dhe nënshkrimi i Ortakut të Shoqërisë

**Esmeralda HODAJ**

